

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Lushnje, projektvendim për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 387 nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste për vendosje të materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, projektvendim për miratimin e manualeve teknike të platformës elektronike të raportimit financiar, projektvendim për raportimin financiar në platformën elektronike të raportimeve financiare për subjektet zgjedhore, raportimin mbi informacionin e dërguar nga bashkitë për zbatimin e vendimeve për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike, projektvendim për plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Tropojë, dhe në fund shqyrtimin e kërkesave për akreditim vëzhguesish nga disa organizata dhe institucione ndërkombëtare. Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditëspër shqyrtimin e raportit të AMA-s për periudhën 23- 30 prill.

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit. Neni 85 i Kodit Zgjedhor shprehet për monitorimin e fushatës zgjedhore në media, që kryhet nga enti rregullator, në këtë rast është Autoriteti i Medias Autovizive, i cili ka detyrimin të pasqyrojë gjendjet e veta nga procesi monitorimit në raporte të detajuara dhe t’ja paraqesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë, pra raportet shoqërohen sipas rastit me propozime për masa administrative. Në raportin e dytë dërguar nga AMA, vendimi numër 3, janë pasqyruar treguesit e monitorimit si dhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi depozitimet në AMA të përmbajtjeve të regjistruara nga OSHMA-të, kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim për transmetimin në kohë reale dhe hapësirën për çdo faktor politik, kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim për trasmetimin e emisioneve, reklamat politike si dhe raportin gjinor të mbulimit mediatic të kandidatëve. Në lidhje me treguesin e parë depozitimi i regjistrimit në AMA, radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Detyrim për depozitim e transmetimeve të çdo dite parashikohet edhe me metodologjinë e monitorimit të medias dhe audios audiovizive sipas kësaj metodologjie OSHMA-të vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese, janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetimeve në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese. Në bazë të raportit të AMA-s rezulton se katër subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar, pasi nuk kanë depozituar regjistrimet për periudhën 23-30 prill 2023. Nga këto subjekte audiovizive rezultojnë të mos kenë depozituar regjistrimet që nga data 14 deri në 30 prill, dhe për këtë AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve marrjen e masave administrative ndërsa një ofrues shërbimesh nuk ka depozituar për gjithë periudhën dhe për këtë AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tërheqjen e vëmendjes të kësaj OSHMA-së. në lidhje me të dhënat mbi edicionet informative Radio Televizioni Publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për gjithë partitë parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marrë deri në 20 % të vendeve në Kuvend. Duke qënë se këto raporte kohore nuk janë respektuar në disa OSHMA, AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kompesimin në kohë të transmetimit në edicionet informative për efekt balancimi. Gjithashtu në lidhje me treguesin reklamave politike referuar nenit 84 të Kodit Zgjedhor koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secili radio apo televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. Në bazë të vendimit të AMA-s vendimi numër 33, rezulton se një subjekt audioviziv nuk e ka respektuar detyrimin ligjor pasi ka tejkaluar kohën prej 90 minutash, për këtë arsye AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar dhe të lejuar nga Kodi Zgjedhor. Në lidhje me treguesit reklamave politike të parashikuara në pikën 7,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen nëpërmjet intervaleve kohore nga ora 15-18 dhe nga ora 21-24 të programit ditor. Në bazë të vendimit numër 33 të AMA-s rezulton se 7 subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcaktuar duke rezultuar reklama jashtë fashave orare të lejuara, për këtë arsye AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike në kohën e ndaluar. Përsa i takon vlerësimin ligjor AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të tërheqi vëmëndjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit ligjor në fushën zgjedhore. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe vendimin numër 33 të AMA-s, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit. Përfaqësues të partive politike të subjekteve. Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Përfaqësuesi i PD R. Kthupi: : Ndjesë! Mesa duket zoti Komisioner projektvendimi që është paraqitur është projektvendimi që është bazuar mbi këto që janë raportimet edhe konkluzionet e AMA-s, kështu që nuk shikojmë që ka një opsion tjetër për të tejkaluar që është projektvendimi ose për të marrë një ndryshim në projektvendim. Problemi që kemi nga ana politike, është që koha e mbetur për fushatën vështirë se mund të zgjidhi çështjen e kompensimit të minutazheve sipas asaj që parashikon projektvendimi, nga sot jemi më pak se 6 ditë fushatë, përfshirë ditën e sotme 7 bashkë me të premtën, kështu që në këtë periudhë të shkurtër kohore, domethënë, mirë është që KQZ-ja të veproj pak më shpejtë lidhur me detyrimin e OSHMA-ve për të transmetuar raportet dhe për të kompensuar atë që është minutazhi i partive politike.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit, përfaqësues të Bashkë Fitojmë.

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: Faleminderit zoti Celibashi, atëhere në lidhje me pikën 1 të rendit të ditës nuk kemi asnjë kundërshtim përse kohë është AMA ajo që e ka bërë propozimin dhe është organi kompetent në lidhje me monitorimin e mediave, por duke marrë shkas dhe nga ajo çka u publikua dhe dje në media desha të sjell jashtë rendit të ditës, të tërheq vëmëndjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për një çështje mjaft të rëndësishme ku ne Koalicioni Bashkë Fitojmë, gati po marr shkas nga

Z. I. Celibashi: Ndjesë që po ju ndërpres, ta përfundojmë këtë pikë dhe pastaj

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: : Në rregull, thjesht ishte për shkresën që kemi depozituar sot në mënyrë zyrtare.

Z. I. Celibashi: : Dakord jam por do iua jap fjalën përsëri. Mirë dakord, atëhere duke marr në konsideratë edhe propozimin e përfaqësuesit të Partisë Demokratike, i cili ka gjithë sensin e vet, do të urdhërojmë menjëherë për kompensimet përkatëse sipas gjetjeve të AMA-s dhe ndërkohë edhe për pjesën tjetër të rekomandimeve do t'i përmbahemi propozimeve të AMA-s për të gjitha masat. Pra ajo çka është më e rëndësishme të ridentojmë është që duke filluar nga sot të njoftohen operatorët radioteleviziv mbi detyrimet për të bërë kompensimet në minutazhe, sipas rastit, për subjektet që përfitojnë këto kompensime dhe për ato operatorë radioteleviziv që kanë transmetuar, që transmetojnë reklama politike jashtë kësaj fashë orare, t'u bëhet me dije që nuk do duhet ta bëjnë përndryshe do të sanksionohen, edhe kjo t'u njoftohet

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

brenda ditës së sotme. Për çështje të tjera pastaj në vlerësim në ditët në vijim. Dakord? Po, atëhere vazhdojmë, t'i mbyllim këto pastaj. apo kjo lidhet me ndonjë nga çështjet e rendit të ditës?

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: : Në gjykimin tonë mund të përfshihej dhe në rend të ditës së ditës së sotme nëse

Z. I. Celibashi: : E kam fjalën t'i përfundojmë këto çfarë kemi pastaj

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: : Ju e dini më mirë, e lëmë në fund nuk është problem.

Z. I. Celibashi: : Pyetja që kam është nëse ka ndonjë lidhje me ndonjë çështje konkrete ajo

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: : Çështje konkrete ishte për subjektin, po themi, për kandidaten e Roskovecit.

Z. I. Celibashi: : Në rregull do t'jua jap fjalën për këtë dhe do ta diskutojmë.

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: : Në rregull, faleminderit.

Vendimi nr. 451

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

propagandistike nga vendimet e kryetarëve të bashkive. Nga monitoruesit e fushatës zgjedhore janë konstatuar shkeljet si më poshtë, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, janë hapur zyra zgjedhore në kundërshtim të pikës 1, të nenit 5 të urdhëzimit numër 6,

Z. I. Celibashi: Nuk ka nevojë ta persërisim këtë se e kemi bërë.

Znj. V. Ballgjini: Nuk ka nevojë, dakord, atëhere në lidhje me çfarë është raportuar

Z. I. Celibashi: Pra ky është projektvendimi?

Znj. V. Ballgjini: Po, në lidhje me çfarë është raportuar nga monitoruesit, po i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e këtyre zyrave zgjedhore për të gjitha zyrat që janë raportuar.

Z. I. Celibashi: Mirë, vazhdojmë gjë tjetër nuk kemi? Nuk kemi gjë tjetër? Mirë, atëhere bazuar në gjetjet e raportit të monitoruesëve për periudhën 7 mars-2 maj 2023 vendosim urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljene. Zyrave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste në njësinë Shkozet, Durrës, pasi është rreth 80 metra nga Qendra e Votimit, që është vendosur në shkollën 'Beqir Çela', po dhe zyrës zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë e cila ndodhet afër Qendrës së Votimit në Pallatin e Kulturës Kavajë, ka më pak se 150 metra, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zyrë zgjedhore e vendosur më pak se 150 metra nga shkolla 'Bajram Curri' në Kukës, zyrën zgjedhore të Koalicionit Bashkë Fitojmë në shkollën 'Naim Frashëri' dhe në shkollën 'Gustav

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Major' në Tiranë, po zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë në rrugën Milto Tutulani është 58 metra larg nga Universiteti i Drejtësisë Tiranë, domethënë ashtu si asti i subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe për këtë subjekt këto zyra zgjedhore janë të vendosura pranë godinave dhe Qendrave të Votimit në distancë që nuk lejohet sipas ligjit, po në adresën Margarita Tutulani, te shkolla 'Dëshmorët e Lirisë' Tiranë, zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë, zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë pranë Universitetit 'Aleksandër Xhuvani' në Elbasan, është 50 metra në distancë, po zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë afër Qendrës së Votimit të shkollës 'Bajram Curri' në Kukës, zyrë zgjedhore e subjektit zgjedhor Partia Demokratike në adresën rruga Nasip Pavullo pranë Liceut 'Jordan Misja'. Gjithashtu urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike, ose materialet propagandistike vijuese, billboardet e subjektit zgjedhor Partia Socialiste i vendosur në afërsi të Qendrës së Votimit të Pallati i Sportit 'Ramazan Ngjala' në Durrës, flamuj të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë vendosur në fasadë banimi pranë shkollës së mesme profesionale 'Beqir Çela' në Shkozë, materiale propagandistike vendosur në shtylla ndriçimi nga Koalicioni Bashkë Fitojmë në rrugën Veli Dedi në Tiranë, materiale propagandistike vendosur në fasadë banimi nga subjekti zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK, në rrugën Fatos Bazhaku në Tiranë. Këto janë. Po vazhdojmë me pikën tjetër.

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: I nderuar, një saktësim të vogël, ose një ndërhyrje të vogël domin, që në lidhje me këtë vendimmarrje të na zbardhet sa më shpejtë, në mënyrë që edhe ne tja përcjellim degëve, dhe të marrim masat e menjëhershme, faleminderit.

Vendimi nr. 452

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

06.05.2023
Ora 12:54

RENDI I DITËS

3.Projektvendim “Për shqyrtimin administrative të denoncimit nr. 369 nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, për afishimin e materialeve propagandistike në vendet e reklamave ndriçuese, në ambientet publike të Bashkisë Kukës, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF, PD**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve, po vazhdojmë me projektvendimin për shqyrtimin administrativ i denoncimit 369 nga Koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialeve propagandistike në vendet publike të ndriçuara të Bashkisë Kukës, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste, pra ankesa është e Koalicionit Bashkë Fitojmë për materialet propagandistike të Partisë Socialiste të vendosura në kundërshtim me ligjin në Bashkinë e Kukësit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Znj. V. Ballgjini: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me numër 45/53, protokolluar datë 3.05.2023, me denoncues zotin Ivi Kaso, regjistruar me numër ID 369ID, nëpërmjet të cilit ndër të tjera pretendohet në Bashkinë Kukës është konstatuar afishimi i materialeve propagandistike në vendet e reklamave ndriçuese nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidatët për Kryetar Bashkie Kukës i po këtij subjekti zgjedhor. Pala kërkuese kërkon heqjen e materialeve propagandistike statike, posterat dhe billboarderat, të vendosura në rrugët kryesore të Bashkisë Kukës nga Partia Socialiste, dega Kukës. Në vijim të procedurës administrative Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimin e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar gjithashtu nga monitoruesit e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e Bashkisë Kukës, nëpërmjet adresës së postës elektronike informacion në lidhje me afishimin e këtyre materialeve propagandistike, nëse vazhdojnë të jenë akoma të afishuara nga ku rezulton se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin ‘Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...’ dhe më pas të vazhdojë emri i subjektit. Në datën 3 maj 2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimi 424 për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin ‘Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...’. Me shkresën 46/12 protokolluar si dhe në datën 4.05.2023 i është përcjellë vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të gjitha bashkive dhe Policisë së Shtetit lidhur me heqjen e këtyre materialeve propagandistike. Nëpërmjet email-it të datës 4 maj 2023, i është kërkuar Partisë Socialiste të Shqipërisë për marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e materialve propagandistike në kundërshtim me përcaktimet e këtij udhëzimi. Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi si dhe raporti e monitorimit,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

vlerësojmë se raportet propagandistike janë vendosur në kundërshtim të pikës 3, të udhëzimit numër 6, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: Denoncimi ka ardhur pasi ka dal, po flasim për një situatë tjetër?

Znj. V. Ballgjini: Po, po.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i koalicionit diçka tjetër për të shtuar përveç asaj që është paraqitur në denoncimin tuaj.

Përfaqësuesi i BF F. Nuri: Jo, në lidhje me denoncimin nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar por thjesht shqetësimi mbetet dhe është i përgjithshëm që këto fenomene vazhdojnë dhe shpresojmë që sipas asaj që dhe ju vendosët që deri të premtën në orën 24 duhët të vijnë në mos gaboj raportimet nga Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për marrjen e këtyre masave dhe për ecurinë e këtyre masave, dhe do donim të dinim se çfarë po ndodh dhe si është proceduar me heqjen e tyre në të gjithë Shqipërinë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëhere në vlerësim të çfarë u relatua dhe u referua këtu, do të vendosim që të hiqen menjëherë të gjitha këto materiale propagandistike përsa kohë janë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e akteve të tjera nënligjore përkatëse të KQZ-së për Bashkinë e Kukësit në vlerësim të denoncimit të bërë nga Koalicioni Bashkë Fitojmë.

Vendimi nr. 453

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKVURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

**06.05.2023
Ora 12:58**

RENDI I DITËS

4.Projektvendim “Për shqyrtimin administrative të denoncimit nr. 370 nga Partia Demokratike e Shqipërisë mbi keqinformimin nga disa subjekte mediatike”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF, PD**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën 4 shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 370 nga Partia Demokratike e Shqipërisë në lidhje me raportimet e disa subjekteve mediatike.

Znj. V. Ballgjini: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar një ankesë me numër 45/69 protokoll datë 3 maj 2023 nga denoncuesi zoti Enkeled Alibeaj, regjistruar nëpërmjet ID 370, nëpërmjet të cilës pretendohet se disa subjekte mediatike i referohen zotit Berisha si kryetar i Partisë Demokratike. Pala kërkuese kërkon fillimin e menjëhershëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të një hetimi administrativ dhe marrjen e masave të nevojshme për garantimin e informimit objektiv dhe të vërtetë të qytetarëve. Në vijim të procedurës administrative ka nisur hetimi administrativ duke i kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e

***Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

denoncuesit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi morri në administrim këtë denoncim i dërgoi shkresë Autoritetit të Mediave Audiovizive në datën 5 maj 2023, për kërkesë informacioni sipas të cilës pretendohet se mediat audiovizive transmetojnë informacione lidhur me paraqitjen e zotit Berisha si kryetar i Partisë Demokratike. Në kuadër të shqyrtimit të këtij hetimi i është kërkuar AMA-s të na bëj me dije lidhur mesa është pretenduar më sipër. Jemi në pritje përgjigjes edhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizive nëse është konstatuar diçka e tillë edhe nga ata.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Përfaqësuesi i PD, R. Kthupi: Atëhere Komisioner e para punës ankesa fillimisht është depozituar në datë 13 ose në datë 18 më saktësisht, ankesa e parë se kjo është ankesë vijuese nuk ka ardhur në datë 3 maj, zyrtarisht në datë 18 prill, dhe 3 maj është riparazitja e ankesës paraqitur më 18 prill, tani padashur, duke mirëkuptuar gjithë ngarkesën që ka KQZ-ja, por problemi është që veprime të tilla në kohë, nëse sot do jemi në kushtet ku AMA detyrohet të na kthejë përgjigje do jetë prapë ditën e premte ku efekti i hetimit administrativ do të jetë nul përse i përket asaj që kërkohet të arrij.

Z. I. Celibashi: Po qartë, por me pak fjalë thelbi i pretendimit ky është që në referimt që i bëhet

Përfaqësuesi i PD, R. Kthupi: E para punës në referimet që i bëhet nëse do kishte një vendim që Komisioni duhet ta merrte, duhet ta merrte më parë në kohë, panvarësisht faktit që unë e kuptoj që në rrugë administrative do duhet të merret raporti i AMA-s në lidhje me këtë gjë, domethënë ne të gjithë jemi konsumatorë të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

emisioneve radiovizive, konstatimi mund të bëhet kryesisht edhe thjesht duke i ndjekur emisionet, domethënë pa i hyrë rrugës administrative, çështja është që nëse vonohemi në kohë në veprime, produkti që marrim është përtej asaj që do duhet të ishte logjika e zbatimit të ligjit.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Koalicionit Bashë Fitojmë.

Përfaqësuesi i BF, F. Nuri: Faleminderit zoti Celibashi, një ndërhyrje të shkurtër në lidhje me këtë ankimim që tani u vumë dhe ne në dijëni, nuk më duket ndonjë problem shumë shqetësues se çfarë opinioni kanë gazetarët apo mediat e caktuara, sepse ata e dinë fare mirë se kush është kryetari i Partisë Demokratike, secili e di vet dhe ka gjykimin e tij, nuk mendoj se do të jetë vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo e AMA-s që t'i diktoj dikujt ndonjë gazetari apo medias se si mendojnë ata apo cili mund të jetë opinioni dhe gjykimi tyre mbi faktin se kush është kryetari i Partisë Demokratike apo të ndonjë subjekti tjetër zgjedhor. Mediat duhet të kenë vijën e tyre editoriale, lirshmërinë, lirinë e tyre editoriale dhe të medias dhe gjykojmë se njerëzit e dinë shumë mirë, shumica e dinë shumë mirë se kush është kryetari i Partisë Demokratike, që është zoti Berisha.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Përfaqësuesi i PD, R. Kthupi: Atëherë Komisioner ne kemi një shqetësim , që është një shqetësim pragmatist. Duke qënë se një pjesë e mediave raportojne zotin Berisha, si kryetar të Partisë Demokratike, ajo që mund të ndodhë është gabimi që AMA pastaj kur bën minutazhin ta llogarisi siç është gabim, të na e llogarisë zotin Berisha si pjesë të Partisë Demokratike. Ky është problemi që kemi, prandaj shqetësohem.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Se mund të konfuzojmë AMA-n, se përsa i përket linjës editoriale pavarsisht se ligji thotë që teorikisht institucionet duhet të respektojnë atë që është ligjshmëria dhe të japin një informacion të drejtë dhe të saktë. Nuk mendoj që jemi në kushtet kur e drejta e linjës editoriale mund të prevalojë mbi vërtetësinë e informacionit që përcillet. Kjo është thelbi i ankesës.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit, mendoj që argumenti juaj i fundit qëndron. Këtu nuk flitet për qëndrimin apo për pikëpamjet që media të caktuara mbajnë ndaj udhëheqësve të ndryshëm politik, po flitet për pasqyrimin e një fakti juridik. Në këtë rast tej asaj nëse ky fakt është pasqyruar ashtu sikurëse do të duhet të pasqyrohet, ndoshta nuk është kaq e domosdoshme që të presi një përgjigje nga Autoriteti Mediave Audiovizive. por mund t'iu bëhet me dije si Autoritetit të Mediave Audiovizive ashtu edhe operatorëve radioteleviziv mbi këtë fakt juridik. Pastaj çështja e politikës editoriale apo qëndrimeve që mbajnë media të caktuara është tërësisht në vlersim të tyre dhe besoj që as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po as AMA nuk mund të ndërhyjnë. Por ne, kemi detyrimin që këtë fakt juridik t'ia bëjmë me dije ashtu sikurse është, kështuë qe e konsiderojmë të përfunduar sot me këtë vendimarrje, ankimin e paraqitur nga Partia Demokratike pa patur nevojën për të pritur një përgjigje formale nga ana e AMA-s.

Vendimi nr. 454

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë “ në aksin rrugor kombëtar nga Tirana për në Lushnje”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**
 - **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 386, nga Organizata KRIIK në lidhje me afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste për aksin rrugor Kombëtar nga Tirana në Lushnje.

Znj. V. Ballgjini: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi, me denoncues Koalicioni Reforma Integrim dhe institucione të konsoliduara KRIIK, regjistruar me numër 386\ID, nëpërmjet të cilit pretendohet se në aksin rrugor nga Tirana në Lushnje, përkatësisht në Bashkitë Lushnje, Rogozhin, Kavajë dhe Durrës, janë afishuar materiale propagandistike në

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Ky denoncim është shqyrtuar në seancën e mëparëshme dhe nga verifikimet që kemi, rezulton se dhe nga raportet e monitoruesve materialet propagandistike të afishuara në këto akse rrugore janë të vendosura pa përmbajtjen e shënimit prodhuar nën përgjegjësinë ligjore dhe më pas të vijojë emri i subjektit zgjedhor. Referuar dhe vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 424, për urdhërimin e policisë Bashkiake dhe policisë në Shtet, për heqjen e këtyre materialeve propagandistike, sikurse dhe ky vendim i është referuar dhe dërguar policisë Bashkiake dhe policisë së Shtetit. Mendojmë që këto materiale propagandistike duhet të hiqen pasi nuk përmbajnë shënime, pra e kemi marrë një vendim me numërin 424, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike që nuk përmbajnë këtë shënim.

Z. I. Celibashi: Qoftë edhe për këtë arsye ato materiale do të duhet të hiqen brenda 24 orëve duke llogaritur si... ose brenda një dite më mirë të themi, duke e llogaritur nga dita e sotëme.

Përfaqësuesi i BF, F. Nuri: Po, faleminderit zoti Celibashi, në lidhje me këtë pikë thjeshtë një sqarim dhe një kërkesë gjithashtu. E para bashkohem me atë iden që u tha nga parafolësi, se një vendimarrje e tillë në kushtet ku kanë ngelur dhe 6 ditë fushatë efektive po themi, është e vonuar në gjykimin tonë, masat duhet të ishin marrë kohë më parë. Qytetet janë mbushur me postera të tillë, një pjesë ka filluar të hiqet po pjesa më e madhe janë. Në autostradë ne kemi vënë re që janë shtuar dhe të tjera të reja, ditët e fundit. Bashkitë duhet të ishin pastruar, bashkitë duhet të kishin marrë vendim për përcaktimin e vendeve se ku do të afishoheshin posterat,

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

apo materialet e tjera propagandistike dhe sikundër pamë dhe në të dy mbledhjet e kaluara. Një pjesë e mirë e bashkive, duke përfshirë dhe Bashkinë Tiranë nuk, ishin përgjigjur dhe nuk e kishin sjellë në kohë, nuk kishin vendosur vendet e afishimit nuk i kishin përcaktuar. Ndaj do të kërkonim në shtesë të kësaj që të merren masa administrative, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor zoti Celibashi, ndaj të gjithë kryetarëve të bashkive që kanë shkelur ligjin.

Z. I. Celibashi: Po, patjetër jemi duke përpunuar gjithë informacionin dhe raportin e dërguar nga bashkitë, policitë Bashkiake dhe policia e Shtetit ,për këtë çështje dhe me siguri në rastet që do të verifikohen që nuk janë përgjigjur urdhërimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të ketë sanksione. Në lidhje me këtë çështje me ankesën e KRIIK, ankesën numër 386, sikurse thashë e vlersojmë të ligjshëm këtë denoncim dhe brenda 24 orëve, ose deri nesër në orën 24:00 më mirë të themi, të ditës së diel duhet të jenë marrë masat për rregullimin e kësaj paligjshmërie dhe heqjen e këtyre materialeve.

Vendimi nr. 455

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimit numër 387, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste ndaj subjektit zgjedhor koalicionit Bashkë Fitojmë , për vendosjen e materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin.

Znj. V. Ballgjini: Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ka sjell një denoncim regjistruar me numër 387/ID, për subjektin zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë, për afishimin e një materiali propagandistik në Bashkinë Kavajë, në fasadën e godinës së postës Shqipëtare të Bashkisë Kavajë. Në vijim të procedurës administrative filloj hetimi administrativ duke kërkuar informacion lidhur me pretendimin e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u ka

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

kërkuar monitoruesve, të monitorojnë këtë lloj afishimi materiali propagandistik nëpërmjet imeil-it të datës 19 prill, theksohet që ky material propagandistik rezultoi të jetë i afishuar në fashdën e institucionit postë Shqipëtare e Bashkisë Kavajë, gjithashtu nga raporti i monitoruesit rezultoi se ky material propagandistik nuk përmban shënimin gjithashtu prodhuar nën përgjegjësinë ligjore dhe të vijojë emri i subjektit zgjedhor i cili e afishoi këtë material propagandistik. E njëjta procedurë është ndjekur edhe me këtë denoncim, i është dërguar vendimi 424, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, policisë bashkiake dhe policisë së shtetit, për të marrë masa për heqjen e këtij materiali propagandistik.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit, meqënëse është edhe përfaqësuesi i koalicionit Bashkë Fitojmë, po e sjellim në vëmendje që ky material do të duhet të hiqet edhe për arsyen që është vendosur në një institucion publik, përndryshe edhe ky deri nesër në orën 24:00, do të urdhërohet të hiqet nga policia bashkiake ,po me siguri që vetë subjekti zgjedhor do të marrë masa për ta lëvizur për ta zhvendosur atë material propagandistik.

Vendimi nr. 456

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 391 nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në Bashkinë Elbasan”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kemi dhe një ankesë në lidhje me vendosjen e materialit propagandistik për subjektin zgjedhor Partia Socialiste Elbasan.

Znj. V. Ballgjini: Po, sot ka ardhur një ankesë nga koalicioni Bashkë Fitojmë për subjektin zgjedhor Partia Socialiste, për një material propagandistik të vendosur në fasadën e godinave të banimit, e cila është e ndaluar. Referuar edhe udhëzimit numër 6, menjëherë i kemi dërguar email subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për të marrë masa të menjëhershme për heqjen e këtij materiali propagandistik, gjithashtu është njoftuar edhe monitoruesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën e Elbasanit, për të vërtetuar dhe verifikuar nëse është apo jo material propagandistik në këtë fasad.

*Zbardhi materialin audio
Jonida Kocaqi*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

Z. I. Celibashi: I njëjti arsyetim si për rastin e Kavajës, do t'i kërkohet subjektit zgjedhor Partia Socialiste, për ta hequr atë material propagandistik sikurse në fakt e kemi bërë, përndryshe policia bashkiake ose policia e shtetit deri nesër në ora 24:00 duhet ta heqë.

Vendimi nr. 461

*Zbardhi materialin audio
Jönida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:13

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e manualeve teknike të përdorimit të platformës elektronike të raportimit financiar”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (Z. Franci Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Shkurt për manualin teknik të përdorimit të platformës elektronike dhe raportimit financiar, edhe pastaj për raportimet financiare në platformën elektronike.

Znj. V. Ballgjini: Objekti i këtij projektvendimi është të udhëzoj në mënyrë të plotë, të plotësimin të raporteve financiare nga kategoria të ndryshme të përdoruesve të platformës elektronike të raportimit financiar. Projektvendimi pasqyron mënyrën e sakt të plotësimin të, të dhënave për secilin zë në platformën elektronike, nga partitë politike kandidatët e partive politike, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, monitoruesit si dhe audituesit ligjor, për vitin kalendarik ashtu edhe për fushat zgjedhore. Manualët teknike të përdorimit, synojnë të shpjegojnë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojnë partitë politike, kandidatët, monitoruesit

*Zbardhi materialin audio
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 06.05.2023*

dhe audituesit për mënyrën e plotësimin të raporteve financiare sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në funksion të këtij qëllimi janë përgatitur 7 manuale teknike përdorimi, përkatësisht manuali teknik i përdorimit të platformës elektronike të raportimit financiar, nga financierët e partive politike gjatë zgjedhjeve sipas shtojcës numër 1, që i bashkëlidhet vendimit, manualit teknik i përdorimit të platformës elektronike nga financierët e partive politike gjatë vitit kalendarik sipas shtojcës numër 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, manuali teknik i përdorimit të platformës elektronike nga monitoruesit e fushatës zgjedhore, sipas shtojcës numër 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, manuali teknik i përdorimit të platformës elektronike nga audituesit ligjor, sipas shtojcës numër 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, manuali i përdorimit teknik të platformës elektronike nga kandidatët e listave shumëmemërore, shtojca numër 5 që i bashkëlidhet këtij këtij vendimi, manuali teknik i platformës elektronike nga kandidatët për kryetar bashkie, shtojca numër 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe manuali teknik i përdorimit të platformës elektronike të raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, sipas shtojcës numër 7, të këtij vendimi, bashkëlidhur vendimit për shqyrtim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Ju, ja keni përcjell për njohje dhe komente të ndryshme për mendime edhe organizatave të shoqërisë civile, edhe partive politike edhe nuk kemi patur ndonjë koment shtesë. Mirë atëherë e miratojmë, sipas draftit të propozuar, manualin e përdorimit të platformës elektronike të raportimit financiar.

Vendimi nr. 457

*Zbardhi materialin audio
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:16

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për raportimin financiar në platformën elektronike nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me projektvendimin për raportimin financiar në platformën elektronike nga subjektet zgjedhore.

Znj. V. Ballgjini: Objekti i këtij projektvendimi është përcaktimi i kategorive të subjekteve zgjedhore që do të plotësojnë dhe do të dorzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportimin financiar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nëpërmjet platformës elektronike të raportimit financiar. Mënyrën e dorzimit të raportit financiar të Partisë Politike pasi e ka ngarkuar në platforme, mënyrën e dorzimit të raporteve nga kandidatët për kryetar bashkie pasi e kanë ngarkuar në platformë, mënyrën e dorzimit të raportit nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit pasi e kanë ngarkuar në platformë. Në fakt

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

në orën 12:12 minuta sot ka ardhur një e-mail, nga organizata KRIIK, lidhur me këtë projektvendim në të cilën organizata KRIIK, pretendon se ky projektvendim duhet të përfshinë pra të gjithë subjektet zgjedhore përfshirë dhe kandidatët e listave shumëëmërore.

Z. I. Celibashi: Po, duke e kuptuar sensin e kësaj kërkesë, dua të them që për faktin që kjo platformë për herë të parë do të përdoret nga kategoria e të gjithë atyre që kanë detyrimin për të bërë raportimin . Shohim objektivisht të pamundur që për këtë kategori pra për të gjithë kandidatët për kohën që kemi në dispozicion realisht dhe objektivisht, ta bëjmë të detyrueshme që këtë raportim ta paraqesim vetëm nëpërmjet platformës, kështu që mendoj do të ngelemi vetëm tek një pjesë e kësaj kategorie, që ka detyrim për të raportuar nëpërmjet platformës duke shpresuar dhe besuar që në fakt do të jetë realiste dhe është realiste, vetëm për këtë kategori, për periudhën që kemi në dispozicion që raportimet të bëhen vetëm nëpërmjet platformës. Natyrisht që ky është një hap i parë dhe një eksperiencë e parë dhe do të duhet kohë që të gjitha kategoritë të familjarizohen me përdorimin e kësaj platforme, por në kushtet kur janë 23 mijë kandidat, në gjykimin dhe në vlersimin e KQZ-së, nuk është shumë realiste që të kemi detyrimin ndaj tyre, të imponuar nga KQZ, për të raportuar nëpërmjet platformës. Jo vetëm nëpërmjet platformës ku edhe nga pikpamja ligjore sa kohë që ky urdhërim nuk mund të jetë kategorik atëherë nuk duhet tju heqim mundësin që ta bëjnë raportimin edhe sipas formës klasike, kështu që akti do të ngelet sipas draftit të propozuar dhe me siguri pastaj pas përfundimit të këtyre zgjedhjeve, do të duhet që KQZ po dhe organizatat e shoqërisë civile, partitë politike do të duhet të angazhohen në trajnimin e subjekteve që do të duhet të raportojnë për financat e gjatë fushatës

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

zgjedhore përfshi dhe kandidatët. Për raportimin e bashkive akoma nuk e kemi të plotë informacionin kështu që do të presim edhe sot, ndërkohë t'u bëj dhe një kujtesë qoftë bashkive, policive bashkiake, policia e shtetit e ka sjellë raportin në djetorë të ditëve por policive bashkiake dhe bashkive, personave përgjegjës tu bëhet një kujtesë për ata që nuk e kanë sjellë informacionin. Nuk e dimë për momentin si është kjo situatë.

Vendimi nr. 458

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Raportim mbi informacionin e dërguar nga Bashkitë për vendimin për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (Z. Franci Nuri)**
- Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Për raportimin e bashkive akoma nuk e kemi të plotë informacionin kështu që do të presim edhe sot, ndërkohë t’u bëhet edhe një kujtesë, qoftë bashkive, policive bashkiake. Policia e shtetit e ka sjellë raportin në djetën e sotme por policive bashkikë dhe bashkive, personat përgjegjës në bashki t’u bëhet një kujtesë për ata që nuk e kanë sjellë informacionin, nuk e dimë për momentin si është kjo situatë.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

**06.05.2023
Ora 13:21**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërorë e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, z. Florin Hazir Ponari”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF, PD**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kemi pikën e parafundit, plotësimin e vakancës nga Këshilli i Bashkisë Tropojë.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tropojë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës nga Këshilltari zoti Rifat Muhamed Musaj propozuar nga Partia Social Demokrate, referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijus nga listat shumëemërore të Partisë Social Demokrate, për këshillin e Bashkisë Tropojë të cilit i kalon mandati këshilltarit, është kandidati me numr rendor 9, zoti Hazir Ponari, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklaramit me numër unik 10. Nga verifikimi i formularit

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

të deklaramentit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimin e ligjit numër 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje kërkesës sonë konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime të përbërsve të gjendjes civile dhe nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, referuar pikës 2, kreut 5, të vendimit numër 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkisë Tropojë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin e miratimit, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, vendosim plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zotin Florin Hazir Ponari.

Vendimi nr. 459

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 06.05.2023*

06.05.2023
Ora 13:22

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, të Ambasadave Bullgare, Sllovae dhe Gjermane, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	Z. Ilirjan Celibashi
2. Staf i KQZ:	Z. Y Merkaj, Znj. V. Ballgjini
Parti Politike:	BF (Z. Franci Nuri)
Të tjerë:	KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë më pikën e fundit, me kërkesat për akreditim të vëzhguesve.

Z. Ylli Merkaj: Misioni i vëzhgimit të OSBE/ODIHR-it, ka depozituar kërkesën për akreditimin e 177 vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyes. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës ka depozituar kërkesën për akreditimin e 20 vëzhguesve afatshkurtër, Ambasada Bullgare për dy vëzhgues afatshkurtër, Ambasada Sllovae për 1 vëzhgues afatshkurtër dhe 1 përkthyes dhe Ambasada Gjermane ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyesve. Kërkesat e paraqitura pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga të

Zbardhi materialin audio

Jonida Kocaqi

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 06.05.2023*

gjitha është në përputhje me nenin 6, pika 2 dhe 5 e Kodit Zgjedhor. Në këto kushte propozohet akreditimi i vëzhguesve sipas listës që kanë paraqitur organizatat e ambasadat, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratohen kërkesat për akreditim të vëzhguesve për misionin ndërkombëtar të vëzhgimit të OSBE/ODIHR-it, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, të Ambasadës Bullgare, të Ambasadës Sllovaqe dhe të Ambasadës Gjermane.

Vendimi nr. 460

*Zbardhi materialin audio
Jonida Kocaqi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

**06.05.2023
Ora 13:23**

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me çështjen jashtë rendit të ditës. Ja jap fjalën përfaqësuesit të koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. Franci Nuri: Faleminderit zoti Celibashi, atëherë desha të risjellë për vëmendjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve çështjen që ne kemi depozituar si koalicion Bashkë Fitojmë sot, me numër protokolli 47/25, në lidhje me kërkesën për marrje masash të menjëherëshme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Roskovec zonjën Bufi, njëkohësisht dhe kandidatë e propozuar për këtë bashki nga Partia Socialiste, denoncimi dhe kërkesa vjen nga ne, si koalicion Bashkë Fitojmë, nisur nga publikimi në media i një emisioni ku zonja Bufi ka në një farë mënyre ushtruar presion ose ndikim ndaj një punonjëse të bashkisë, për shkak se kjo punonjëse u tha në atë material mediash, kishte marrë pjesë në një event, një organizim politik të koalicionit Bashkë Fitojmë dhe saktësisht kishte takuar në mos gaboj zotin Berisha apo kishte marrë pjesë në

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.05.2023*

takimin elektoral, ku ishte prezent zoti Berisha në atë zonë. Ne e risjellim në vëmëndje edhe njëherë që këto janë veprime totalisht të ndaluara dhe në kundërshtim, jo vetëm me Kodin Zgjedhor, nenin 91, ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, por edhe përbën vepër penale si pengimi i zgjedhësve apo përdorimi i administratës. Ndaj përfundimisht në këto kushte ne kërkojmë, jo vetëm që shprehim shqetësimin për tendencën e përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale por edhe kërkojmë marrjen e masave të menjëherëshme dhe me urgjencë, kundrejt kryetares aktuale të Bashkisë Roskovec, zonjës Majlinda Bufi. Sipas parashikimeve të nenit 171, vijues të Kodit Zgjedhor, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, besoj ne e kemi administruar dhe e kemi regjistruar si denoncim dhe ndërkohë do të hapim një proces, të shqyrtimit dhe hetimit administrativ, të kërkohet nga të gjitha palët e interesuara apo subjektet e përfshira në këtë shqyrtim, informacionet përkatëse për të disponuar më pas me vendim. Mirë faleminderit ditë të mbarë, seanca mbyllet.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

